

BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

NGA NORMA

NË PRAKTIKË



REPUBLIKA E
MAQEDONISË
MINISTRIA PËR
VETQEVERISJE
LOKALE



BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

NGA NORMA NË PRAKTIKË

Shkup, nëntor 2015

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale “Zgjidhje inovative për qasje më të mirë deri te shërbimet në nivel lokal”, të implementuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

Paralelisht me procesin e decentralizimit, në Republikën e Maqedonisë u aktualizua edhe nevoja për stimulimin e bashkëpunimit ndërkomunal.

Nëse qëllimi përfundimtar i decentralizimit është shërbimi më efikas dhe më ekonomik për qytetarët – bashkëpunimi ndërkomunal është një nga mënyrat e arritjes së këtij qëllimi.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat) kanë kompetenca në të gjitha fushat vitale, të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë mbi cilësinë e jetës së qytetarëve në bashkësitë lokale.

Komunat janë kompetente për kryerjen e punëve sa i përket planifikimit urbanistik (urban dhe rural), lëshimit të lejeve për ndërtimin e objekteve me rëndësi lokale, të përcaktuara me ligj, rregullimin e hapësirës dhe rregullimin e tokës ndërtimore, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, zhvillimin ekonomik lokal, veprimtaritë komunale, kulturën, sportin dhe rekreacionin, mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, arsimin fillor dhe të mesëm, mbrojtjen shëndetësore, mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirat materiale, mbrojtjen nga zjarri, dhe çështje të tjera të përcaktuara me Ligj.

Komunat, kompetencat e përcaktuara i kryejnë përmes administratës komunale ose përmes themelimit të ndërmarrjeve publike lokale dhe institucioneve publike, ndërkaq kryerjen e punëve të caktuara mund ta delegojnë edhe tek persona të tjerë fizikë dhe juridikë, në bazë të kontratës për kryerjen e punëve me interes publik, në përputhje me Ligjin.

Me qëllim të kryerjes më efektive dhe më ekonomike të kompetencave, komunat mund të vendosin edhe bashkëpunim ndërkomunal.

Nevoja për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal është në lidhje të ngushtë me nevojën e zbatimit më efikas të kompetencave të komunave, ofrimin më ekonomik të shërbimeve lokale, përforcimin e kapaciteteve të administratës komunale për zbatimin e obligimeve që burojnë nga procesi i decentralizimit, përgatitjen e dokumenteve strategjike planore, sigurimin e të dhënave të azhuruara për kategoritë e ndryshme të subjekteve në territorin e komunave të përfshira, implementimin e përvojave pozitive nga komunat e tjera dhe ngjashëm.

Pse Ligj për bashkëpunim ndërkomunal

Republika e Maqedonisë është njëri nga shtetet e paktë të cilët këtë fushë e kanë rregulluar me ligj të veçantë. Pse? Për arsye se Republika e Maqedonisë ka vetëqeverisje lokale me një shkallë, përkatësisht të gjitha komunat kanë kompetenca të barabarta, ndërkaq kapacitete të ndryshme administrative dhe financiare.

Sa për ilustrim, komuna më e vogël në shtet, Vevçani ka 2 433 banorë, ndërsa më e madhja Kumanova mbi 100 000 banorë.

Në Republikën e Maqedonisë, 14 komuna kanë më pak se 5000 banorë, ndërsa 30 komuna kanë popullatë deri në 10 000 banorë.

Nga gjithsej 80 komuna, tridhjetë e gjashtë komuna ose thuaja se 50% janë rurale.

Me qëllim të vendosjes së balancës, midis përcaktimit politik për vetëqeverisje lokale

në një shkallë dhe realizimit me sukses të kompetencave të deleguara nga ana e komunave në Ligjin për vetëqeverisje lokale, të miratuar në muajin shkurt të vitit 2002, u përcaktua mundësia e bashkëpunimit ndërkomunal gjatë kryerjes së kompetencave.

Pas delegimit zyrtar të kompetencave tek komunat, më datë 1 korrik të vitit 2005, pritej që komunat menjëherë të shfaqin interesim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal. Praktika dëshmoi se, ndonëse kishte nevojë, një gjë e këtillë nuk ndodhi. Pse? Për shkak se në Ligjin për vetëqeverisje lokale nuk janë trajtuar tërësisht procedurat dhe format e bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkaq komunat të cilat ishin pioniere, sa i përket themelimit të këtij mekanizmi, u ballafaquan me një sërë problemesh lidhur me rregullimin e marrdhënieve të ndërsjella.

Në ndërkohë, nevoja për rregullimin me ligj të

2433

Komuna më e vogël në shtet, Vevçani ka 2 433 banorë

30

Ndërsa 30 komuna kanë popullatë deri në 10 000 banorë

~50%

Nga gjithsej 80 komuna, tridhjetë e gjashtë komuna ose thuaja se 50% janë rurale.

veçantë të kësaj materie ishte cekur pikërisht nga ana e përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale dhe të Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL).

Më datë 17 qershor të vitit 2009, me propozim të Qeverisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 79/2009")

Me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal rregullohet mënyra, kushtet dhe procedura për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe format përmes së cilave realizohet financimi, evidencat dhe mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe çështjet e tjera me rëndësi për bashkëpunimin ndërkomunal (BNK).

Përveç Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, si

mekanizëm për kryerjen e kompetencave ose ofrimin e shërbimeve në nivel lokal, ekzistojnë edhe shumë ligje të tjerë të cilët i rregullojnë fushat në të cilat komunat kanë kompetencë (Ligji për zhvillimin e balancuar rajonal, Ligji për veprimtari komunale, Ligji për varrezat dhe shërbimet funerale, Ligji për menaxhimin me mbeturinat, Ligji për cilësinë e ajrit ambiental, Ligji për transportin në komunikacionin rrugor, Ligji për mjedisin jetësor, Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor, Ligji për ujërat dhe të tjerë).

Në zgjidhjet më të reja ligjore, veçanërisht me ndryshimet e Ligjit për menaxhimin me mbeturina, është evident angazhimi i ligjvënësist që përmes dispozitave të caktuara ta stimulojë bashkëpunimin ndërkomunal, si zgjidhje të detyrueshme për zbatimin e kompetencave të vetëqeverisjes lokale.

BNK përmes dispozitave të Ligjit

Me qëllim që komunat të stimulohen për bashkëpunim të ndërsjellë, ndërkaq duke mos e shkelur parimin e vullnetarizmit, si parim themelor për këtë lloj të bashkëpunimit, me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal përcaktohen instrumentet kryesore për ven-

dosjen e bashkëpunimit dhe formave përmes së cilave do të realizohet.

Bashkëpunimi ndërkomunal, në kontekst të këtij Ligji, është bashkëpunim i cili vendoset midis dy ose më shumë komunave për kryerjen më efektive dhe më ekonomike të kompetencave të komunave, të përcaktuara me Ligj dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta.

Po ashtu, me bashkëpunim ndërkomunal nënkuptohet edhe kryerja e punëve të caktuara të cilat janë në kompetencë të komunave, nga ana e një komune në llogari të një ose më shumë komunave tjera.

Organet kompetente të cilat marrin vendim për vendosjen e bashkëpunimit janë këshillat e komunave.



Nga gjithsej
80 komuna
në Republikën e Maqedonisë,

62 (77,5%)

kanë vendosur
bashkëpunim
ndërkomunal.

Bashkëpunimi ndërkomunal realizohet përmes formave, si vijojnë:

- trupa dhe komisione të përbashkëta të punës;
- trupa të përbashkët administrativ;
- ndërmarrje të përbashkëta publike; dhe
- institucione të përbashkëta publike.

Bashkëpunimi ndërkomunal realizohet edhe përmes bashkimit të mjeteve financiare dhe mjeteve të tjera, si dhe përmes kryerjes kontraktuale të punëve me kompetencë të një ose të më shumë komunave nga ana e një komune tjetër për kompensim të caktuar.

Për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, nuk nevojitet pëlqim paraprak, por për të njëjtin udhëhiqet vetëm evidencë e veçantë në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, financiarisht mund ta stimulojë dhe mbështes bashkëpunimin ndërkomunal të dy ose më shumë komunave, në fushat të cilat janë me rëndësi më të gjerë dhe janë me interes të veçantë për funksionimin e veprimtarive në ato fusha.

Sa i përket dhënies prioritet fushave, të cilat financiarisht mund të mbështeten, Qeveria miraton Vendim për përcaktimin e veprimtarive me rëndësi dhe interes më të gjerë, për të cilat do të mund të

akordohen mjete financiare për stimulimin e bashkëpunimit ndërkomunal.

Kriteret themelore për stimulimin financiar dhe mbështetjen e vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal janë: kapacitetet administrative dhe financiare të komunave për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me Ligj, përfitimet e pritshme nga bashkëpunimi ndërkomunal, numri i komunave, të cilat marrin pjesë në bashkëpunimin ndërkomunal dhe mjetet paraprakisht të siguruara nga burime tjera.

Kriteret më të përafërta për akordimin e mjeteve, si dhe mënyra dhe procedura e



shpërndarjes së tyre, përcaktohen me akt të veçantë të Qeverisë së RM-së.

Qeveria formon komision të veçantë për monitorimin e bashkëpunimit ndërkomunal, të përbërë nga përfaqësues të ministrive kompetente, përfaqësues të këshillave të rajoneve planore dhe nga Bashkësia e Njësie

të Vetëqeverisjes Lokale.

Ligji për bashkëpunim ndërkomunal mundëson ndërlidhjen e të gjitha aktiviteteve për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, në bazë të vullnetit të shprehur të komunave dhe në procedurë të përcaktuara.

Bashkëpunimi ndërkomunal në praktikë

Bashkëpunimi ndërkomunal në Republikën e Maqedonisë realizohet përmes formave të ndryshme dhe në fusha të ndryshme, me qëllim të kryerjes së kompetencave të caktuara lokale.

Bashkëpunimi ndërkomunal mundëson identifikimin dhe prioritizimin më të lehtë të nevojave të mikro-rajoneve të caktuara, por edhe të rajoneve planore, me qëllim të realizimit të zhvillimit lokal të qëndrueshëm, të planifikuar, të integruar dhe inkluziv.

Vendosja e BNK-së, midis të gjitha komunave të një rajoni planor është praktikë gjithnjë e më e shpeshtë, e cila mundëson kryerjen më efikase dhe më ekonomike të kompetencave. I këtillë është edhe shembulli me Rajonin Planor të Vardarit, me atë Verilindor dhe të Pellagonisë, në të cilët komunat kanë formuar trup të përbashkët pune – Rrjet për Zhvillim Inkluziv. Në Rajonin Planor të Vardarit është formuar edhe trupi i përbashkët administrativ për efikasitet energjetik.

Vendosja e formave inovative të bashkëpunimit ndërkomunal është rezultat i nevojës së komunave, sektorit privat dhe shoqërive qytetare, që bashkë dhe përmes qasjes së integruar dhe inkluzive të kontribuojnë për rritjen e konkurrencës së rajonit planor.

Nga analiza e të dhënave të fituara nga komunat, në hulumtimin e zbatuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe UNDP (viti 2014), vihet në pah se Ligji për bashkëpunim ndërkomunal i plotësoi në tërësi pritshmëritë dhe qëllimet e vendosura gjatë miratimit të tij, përkatësisht e stimuloi BNK dhe u mundësoi komunave që përmes këtij mekanizmi, në mënyrë më efikase dhe më ekonomike, t'i kryejnë kompetencat lokale. Ky konstatim, veçanërisht ka të bëjë



Nga bashkëpunimet e vendosura ndërkomunale, sa i përket komunave të përfshira në total në një bashkëpunim ndërkomunal, të dhënat tregojnë se

48

**JANË VENDOSUR
MIDIS DY KOMUNAVE**

8

**PËRFSHIJNË
NGA 3 KOMUNA**

5

**PËRFSHIJNË
4 OSE MË SHUMË KOMUNA**

me komunat rurale dhe të vogla të cilat vetëm përmes vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal mundeshin të fillojnë me kryerjen e kompetencave të caktuara, të parapara me Ligj.

Si shkaqe kryesore për nevojën e bashkëpunimit ndërkomunal, komunat i theksojnë: mungesën e mjeteve financiare, kapacitetet e pamjaftueshmetë administratës komunale (numër i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe mosekzistimi i ekspertizës përkatëse), kushtet joadekuate hapësinore dhe kushtet teknike për punë, mosekzistimin e bazave të nevojshme të të dhënave, mungesën e dokumenteve planore dhe strategjike, bashkëpunimin e pakënaqshëm me institucionet e nivelit qendror, etj.

Jo vetëm komunat e vogla dhe rurale, por edhe komunat e mëdha, përmes vendosjes


së bashkëpunimit ndërkomunal realizojnë kryerje më ekonomike të kompetencave, ndërsa kursimet e realizuara i shfrytëzojnë për aktivitete të reja në kuadër të kompetencave të tyre.

Në periudhën pas miratimit të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, në bashkëpunim me UNDP kanë siguruar ndihmë profesionale dhe financiare për vendosjen e bashkëpunimeve ndërkomunale, me përfshirjen e mbi 50 komunave. Bashkëpunimi ndërkomunal është identifikuar si praktikë e mirë edhe nga ana e Bashkimit Evropian. Tri komunave pioniere të përfshira në bashkëpunimin ndërkomunal në Republikën e Maqedonisë: Vasilevë, Bosilevë dhe Novo Sellë u është ndarë mirënjohje për vendosjen dhe zbatimin e suksesshme të BNK-së.

	Emri i komunës	Popullata	Sipërfaqja km ²	Vendbanime
1	HARAÇINË	11597	31,30	4
2	BEROVË	13941	598,07	9
3	MANASTIR	95385	787,95	66
4	BOGDANC	8707	114,54	4
5	BOSILEVË	14260	161,99	16
6	BËRVENICË	15855	164,30	10
7	VALLANDOVË	11890	331,40	29
8	VASILEVË	12122	230,40	18
9	VEVÇAN	2433	22,80	1
10	VELES	55108	427,45	29
11	VINICË	19938	432,67	16
12	VRAPÇISHT	25399	157,98	15
13	GJEVGJELI	22988	483,43	17
14	GOSTIVAR	81042	513,39	35
15	GRADSKO	3760	236,19	16
16	DIBËR	19542	145,67	18
17	DEBËRCË	5507	425,39	30
18	DELLÇEVË	17505	422,39	22
19	DEMIR KAPI	4545	311,06	15
20	DEMIR HISAR	9497	480,13	41
21	DOJRAN	3426	129,16	13
22	DOLLNEN	13568	412,43	37
23	ZHELINË	24390	201,04	18
24	ZELENIKOVË	4077	176,95	14
25	ZËRNOVC	3264	55,82	3
26	ILINDEN	15894	97,02	12
27	JEGUNOVC	10790	176,93	17
28	KAVADAR	38741	992,44	40
29	BOGOVINË	28997	141,65	14
30	KARBINCI	4012	229,70	29
31	KËRÇOVË	56734	824	7
32	KONÇE	3536	233,05	14
33	KOÇAN	38092	360,36	28
34	KRATOVË	10441	375,44	31
35	KRIVA PALLANKË	20820	480,81	34
36	KRIVOGASHTAN	6150	93,57	13
37	KRUSHEVË	9684	190,68	19
38	KUMANOVË	105484	509,48	48
39	LIKOVË	27058	267,82	22
40	LLOZOVË	2858	166,32	11

	Emri i komunës	Popullata	Sipërfaqja km ²	Vendbanime
41	MAVROVË DHE ROSTUSHË	8618	663,19	42
42	M. KAMENICË	8110	190,37	9
43	MAKEDONSKI BROD	7141	888,97	51
44	MOGILË	6710	255,62	23
45	NEGOTINË	19212	426,46	19
46	NOVACI	3549	753,53	41
47	NOVO SELLË	11567	237,83	16
48	OHËR	55749	389,93	29
49	PETROVEC	8255	201,93	16
50	PEHÇEVË	5517	208,20	7
51	PLLASNICË	4545	54,44	4
52	PRILEP	76768	1194,44	59
53	PROBISHTIP	16193	325,57	36
54	RADOVISH	28244	497,48	36
55	RANKOVC	4144	240,71	18
56	RESNJË	16825	550,77	44
57	ROSOMAN	4141	132,90	10
58	SVETI NIKOLLË	18497	482,89	33
59	SOPISHTË	5656	222,10	13
60	NAGORIÇAN I VJETËR	4840	433,41	39
61	STRUGË	63376	483,00	51
62	STRUMICË	54676	321,49	25
63	STUDENIÇAN	17246	276,16	19
64	TEARCË	22454	136,54	13
65	TETOVË	86580	261,89	20
66	QENDRA ZHUPË	6519	107,21	23
67	ÇASHKË	7673	819,45	42
68	ÇESHINOVË-OBLESHEVË	7490	132,20	14
69	ÇUÇER -SANDEVË	8493	240,78	12
70	SHTIP	47796	583,24	44
71	AERODROM	72009	21,85	1
72	BUTEL	37371	54,79	4
73	GAZI BABË	72617	110,86	13
74	GJORE PETROV	41634	66,93	6
75	KARPOSH	59666	35,21	2
76	KISELLA VODË	57236	34,24	2
77	SARAJ	35408	229,06	22
78	QENDËR	45362	7,52	1
79	ÇAIR	64823	3,52	1
80	SHUTO ORIZARË	20800	7,48	1


Harta e Republikës së Maqedonisë



QYTETI I SHKUPIT
Popullata 506 926
Sipërfaqja 571,46 km²

REPUBLIKA E MAQEDONISË
Popullata 2 022 547
Sipërfaqja 25 713 km²

Nga gjithsej 62 komuna, të cilat kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal, 18 komuna kanë vendosur një bashkëpunim ndërkomunal, 22 komuna kanë vendosur nga dy bashkëpunime ndërkomunale, 14 komuna kanë vendosur nga 3 bashkëpunime ndërkomunale, ndërsa 8 komuna kanë vendosur 4 ose më shumë bashkëpunime ndërkomunale.



Praktika të vendosura të BNK

Nga gjithsej 80 komuna në Republikën e Maqedonisë, 62 (77,5 %) kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal.

Nga gjithsej 62 komuna, të cilat kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal, 18 komuna kanë vendosur një bashkëpunim ndërkomunal, 22 komuna kanë vendosur nga dy bashkëpunime ndërkomunale, 14 komuna kanë vendosur nga 3 bashkëpunime ndërkomunale, ndërsa 8 komuna kanë vendosur 4 ose më shumë bashkëpunime ndërkomunale.

Nga bashkëpunimet e vendosura ndërkomunale, sa i përket komunave të përfshira në total në një bashkëpunim ndërkomunal, të dhënat tregojnë se 48 janë vendosur midis dy komunave, 8 përfshijnë nga 3 komuna, ndërsa 5 përfshijnë 4 ose më shumë komuna.

Numri më i madh i bashkëpunimeve ndërkomunale janë vendosur në këto fusha: planifikimi urbanistik, kontrolli i brendshëm financiar, kryerja e mbikëqyrjes inspektuese, mjedisi jetësor, zhvillimi ekonomik lokal, veprimtaritë komunale dhe tatimet lokale.

Bashkëpunimi, në më shumë kompetenca është më i pranishëm tek komunat e vogla dhe ato rurale, ndërkaq bashkëpunimi me një kompetencë më së shpeshti realizohet midis komunave të mëdha urbane dhe komunave të vogla urbane ose rurale.

Në kushte të kapaciteteve pamjaftueshëm të ndërhuara, në administratat komunale komunat vendosin të themelojnë bashkëpunim ndërkomunal përmes formave të cilat në thelb nuk do të shkaktojnë ndryshime më të mëdha në strukturën organizative dhe menaxhment.

Komunat, më së shpeshti lidhin kontrata për kryerjen e punëve të caktuara nga ana e një komune për nevojat e një ose më shumë komunave tjera ose formojnë trupa apo komisione të përbashkëta pune.

Më rrallë i qasen formimit të trupave të përbashkët administrativ, ose bashkimit të mjeteve financiare. Edhe pse nevoja është evidente, megjithatë, kryetarët e komunave dhe administrata komunale tentojnë ta

optimalizojnë zbatimin e kompetencave me mjete vetjake dhe resurse njerëzore. Formimi i trupave të përbashkët administrativ kërkon harmonizimin e akteve për sistematizimin e vendeve të punës dhe përshtatjen e organizimit të brendshëm të administratës, por edhe investim në mjetet themelore dhe modelin stabil të financimit të pagave për të punësuarit, e që si proces kërkon një periudhë më të gjatë kohore.

Qyteti i Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, në kuadër të të cilit funksionojnë dhjetë komuna, funksionalitetin e vet e siguron përmes bashkimit të mjeteve financiare me komunat e Qytetit të Shkupit.

Komunat ende pamjaftueshëm realizojnë bashkëpunim me qëllim të themelimit të përbashkët të ndërmarrjes publike ose institucionit të përbashkët publik. Si shkak theksohet procedura e gjatë dhe komplekse, e cila kërkon përpilimin e studimit paraprak për arsyeshmëri ekonomike.

Përvoja, sa i përket inkuorporimit të këtyre formave më komplekse të bashkëpunimit, e vë në dukje nevojën e sigurimit të mbështetjes të drejtpërdrejtë paraprake, profesionale, teknike dhe financiare të komunave, të cilat kanë interes për bashkëpunim, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe përfshirjes së shfrytëzuesve së shërbimeve lokale, si objektivi kryesor.

Sa i përket fushave në të cilat vendoset bashkëpunimi ndërkomunal, vlen të theksohet qëndrimi i një numri të madh të komunave se për komunat “e vogla” bashkëpunimi ndërkomunal është mënyra e vetme për ofrimin e shërbimeve publike në nivel lokal, veçanërisht në fushat: mbrojtja sociale, mbrojtja e mjedisit jetësor,

mbikëqyrja inspektuese dhe mbrojtja nga zjarri. Efikasiteti energjetik, veçanërisht në objektet publike, të cilat shfrytëzohen nga më shumë komuna (shkollat e mesme, ambulancat, kopshtet, etj.) kërkon qasje të përbashkët, megjithatë stimulimet financiare për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal janë kryesore, duke i pasur parasysh investimet në këtë sektor.

Në kuadër të bashkëpunimeve të vendosura, vend të rëndësishëm zënë edhe bashkëpunimet ndërkomunale të cilat vendosen si bazë për realizimin e projekteve të caktuara të përbashkëta, të cilat mundësohen nga donatorë ose përmes aplikimit për fitimin e mjeteve nga programet përkatëse evropiane. Ky lloj i bashkëpunimeve projektuese ndërkomunale, më së shpeshti ndërpriten pas përfundimit të projektit.

Është e domosdoshme që komunat, të cilat kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal, ta bëjnë vlerësimin e funksionimit dhe efektet e arritura nga bashkëpunimi.

Për shkak të evidencës, obligim ligjor është që komunat, të cilat kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal, ta njoftojnë Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe t'i paraqesin aktet për vendosjen e bashkëpunimit.

Me rëndësi të jashtëzakonshme në implementimin e bashkëpunimeve të vendosura komunale është edhe përfshirja e ministrive dhe organeve përkatëse, në përbërje të institucioneve drejtpërsëdrejti përgjegjëse për fushat në fjalë, përkatësisht për kompetencat e bashkëpunimit ndërkomunal.

Përvojat pozitive të BNK

Përfitimet e realizuara për komunitet, të cilat kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal, janë multidimensionale: ekonomike, përfitime në zbatimin e kompetencave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, si dhe përfitime të përgjithshme.

PËRFITIME EKONOMIKE

Shpeshherë këto përfitime shihen si përfitime kryesore të bashkëpunimit ndërkomunal, por edhe si një nga motivet më të rëndësishëm për lidhjen e partneriteteve:

- shpenzime të reduktuara për zbatimin e kompetencave të NJVL, përmes sigurimit të ndërsjellë të shërbimeve publike dhe shfrytëzimit të resurseve ekzistuese njerëzore, financiare, TI dhe resurseve e kapaciteteve të tjera;
- rritje të të ardhurave burimore të komunave përmes regjistrimit dhe azhurnimit të bazave të obliguesve tatimorë, lëshimit të lejeve, etj.

Partneriteti midis Kavadarit dhe Rosomanit rezultoi me rritjen e dyfishtë të të ardhurave nga tatimi mbi pronën e patundshme, ndërkohë pritet që përqindja e arkëtimit të tatimeve dhe taksave të rritet madje deri në 90%. Ky është rezultat i vlerësimit të përbashkët të tatimit mbi pronën i 13.072 amvisërive, prej të cilave 11.462 amvisëri në territorin e komunës së Kavadarit dhe 1610 obligues tatimorë në territorin e komunës Rosoman.

Në komunën e Radovishit dhe Konçes, numri i obliguesve tatimorë është rritur për mbi 30%. Në të ardhmen pritet prurje të rritura financiare në buxhetet për mbi 50% mbi këtë bazë

- Kursime të mjeteve financiare për shkak të optimalizimit të numrit të të punësuarve.

Komuna Kavadar dhe Rosoman, përlogaritë fillestare për punën e seksionit për përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe taksave, i cili duhet të punësojnë më së paku 4 nëpunës të kualifikuar shtetërorë, me bruto - pagë mujore prej 49.000 denarë për një të punësuar, kap shifrën prej 2.380.000 denarë në nivel vjetor. Duke i pasur parasysh resurset ekzistuese, të cilat komuna e Rosomanit i posedon, ky është kursim prej më së paku 1.200.000 denarë në vit për paga.

Në komunitet Novaci dhe Mogilë gjithsej 11 nëpunës shtetërorë drejtpërsëdrejti janë përfshirë në bashkëpunimin ndërkomunal. Kjo nënkupton se nëse nuk është vendosur ky bashkëpunim, me qëllim që ta përmbushin këtë minimum ligjor, që të dyja komunitet duhet të punësojnë nga 11 nëpunës shtetërorë. Duke e marrë parasysh se mesatarisht vetëm për pagën e një nëpunësi shtetëror ndahen nga 500 euro në muaj ose 6000 euro në nivel vjetor, shpenzimi i përgjithshëm për të gjithë nëpunësit e përfshirë shtetërorë në nivel vjetor është në lartësi prej 66.000 euro, po aq sa është edhe kursimi.

Nga bashkëpunimi ndërkomunal realizohen kursime financiare, ndërkaq veçanërisht në trupat e përbashkët administrativ dhe bashkëpunimi kontraktual, më së shumti për shkak të numrit optimal të vendeve të punës. Në shembullin e komunave: Bosilevë, Vasilevë dhe Novo Sellë, kursimi i mjeteve financiare është 12% nga buxheti bazë, të cilin komunitet e ridedikojnë në projekte kapitale për qytetarët.

PËRFITIMET NË ZBATIMIN E KOMPETENCAVE DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Edhe pse kanë kompetencë për t'i mbledhur tatimet dhe taksat lokale, për mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, disa nga komunat nuk ishin në gjendje t'i zbatojnë këto kompetenca ligjore pa vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal. Si përfitim i përgjithshëm i bashkëpunimit ndërkomunal potencohet cilësia e përmirësuar e shërbimeve të ofruara, si dhe:

- Përforcimi i kapaciteteve të administratës komunale për kryerjen e detyrave të punës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore;
- Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe softuer (veçanërisht bazat e të dhënave për kompetenca të caktuara të NJVL: obligues tatimor, ndërtime të paligjshme, kategori të rreziukuara sociale të qytetarëve, operatorë për mjedisit jetësor etj.);
- Ofrim i shpejtë i shërbimeve;
- Kushte të përmirësuara hapësinore për punën e administratës komunale;
- Numër i rritur i informatave, të cilat personat juridikë dhe fizikë mund t'i marrin në njësinë e vetëqeverisjes lokale;
- Dokumente të përpiluara strategjike dhe planore për fusha të caktuara.

Harta e investimeve të komunës Gjevgjeli dhe Vallandovë, si metodë bashkëkohore për tërheqjen e investitorëve vendor dhe të huaj mundësoi 7 biznesmenë vendor të investojnë në ZZHTI "Bllokotehna", ose investitorë të huaj të investojnë në Qendrën tregtare në afërsi të pikës së kalimit kufitar Bogorodicë.

- specializim i ngushtë i të punësuarve në trupat e përbashkët administrativ, por edhe në bashkëpunimin e kontraktuar për kryerjen e punëve nga njëra komunë në llogari të komunës tjetër.

PËRFITIME TË PËRGJITHSHME

- Vetëdije e përforcuar e qytetarëve lidhur me kompetencat e NJVL, si dhe për të drejtat dhe obligimet e tyre në fusha të veçanta (punë tatimore, urbanizëm, zhvillim ekonomik lokal, mbrojtje sociale dhe mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja e mjedisit jetësor etj.);
- Komunë më transparente dhe reduktimi i pikave potenciale të korrupsionit, veçanërisht përmes inkuorporimit të sistemit një-sportel dhe sistemit të administrimit të dokumenteve. Përmes qendrave të vendosura për shërbime të qytetarëve, në komunat partnere (sistemi një-sportel), sigurohet ofertë e shërbimeve prej një vendi në komunë.
- Inkuorporim i procedurave të unifikuara, në përputhje me Ligjin dhe unifikimi i formularëve të nevojshëm për komunikim midis shërbimeve në komunat e përfshira. Kjo nënkupton edhe një hap deri në përmbushjen e kushteve për inkuorporimin e ISO standardeve për cilësi.
- Vende pune përkohësisht të hapura për personat e papunësuar nga territori i komunave partnere (gjatë regjistrimit të target grupeve të caktuara u angazhuan persona jashtë administratës komunale). Në disa raste, personat e angazhuar për kohë të caktuar themeluan marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar (Radovish, Bërvenicë, etj.);
- Komunikim i përmirësuar, bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave midis komunave partnere;

- Përmirësim i marrëdhënieve ndëretnike midis dhe në komunat të përfshira me Projektin;
- Promovim i kapaciteteve turistike të komunave partnere;
- Dokumentacion urbanistik planor i siguruar për planifikimin e objekteve të ardhshme për banim dhe industri.
- Kapacitete të përforcuara të administratës komunale për përgatitjen dhe implementimin e projekteve.

Praktika inovative të BNK

RRJETI PËR ZHVILLIM INKLUZIV TË RAJONIT PLANOR TË VARDARIT

Formimi i Rrjetit është nismë e përbashkët e Qendrës për Zhvillim të Rajonit Planor të Vardarit, 8 komunave, degëve të dhomave ekonomike, të zejtarëve dhe të shoqatave të qytetarëve të rajonit planor. Vendosja formale dhe funksionimi fillestar i Rrjetit, nga aspekti teknik dhe financiar, është ndihmuar nga Zyra e Programit për Zhvillim pranë Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Shkup, Qendra për Zhvillimin e RPV dhe 8 komunat e rajonit.

Rrjeti është trup i përbashkët i punës i formuar në bazë të dispozitave të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, me vendime të miratuara nga këshillat e 8 komunave të Rajonit.

Misioni i Rrjetit është në drejtim të përforcimit të koordinimit, të programimit dhe zbatimit të masave dhe aktiviteteve për mbështetjen e sektorit publik, privat dhe joqeveritar, me krijimin e kushteve për zhvillimin e ekonomisë së fuqishme dhe konkurrenente të RPV, ekonomi e cila do të ofrojë mundësi më të mëdha për punësime dhe njëkohësisht do t'i arrijë standardet sociale dhe ekologjike. Përmes aktiviteteve të Rrjetit pritet të reduktohet intensiteti dhe pasojat nga papunësia e theksuar dhe migracioni si një sfidë kryesore socio-ekonomike e Rajonit.

Rrjeti për Zhvillim Inkluziv të RPV ka rol kyç për përforcimin e kapaciteteve të sektorit publik, privat dhe civil për bashkëpunimin dhe koordinimin gjatë zbatimit të aktiviteteve prioritare dhe stimulimin e të gjithë faktorëve në bashkësitë lokale që në mënyrë aktive të marrin pjesë në punën e institucioneve lokale, lidhur me çështjet prioritare që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal. Përveç kësaj, Rrjeti punon edhe në tejkalimin e problemeve dhe “grykave të ngushta” siç është kapaciteti i ulët për absorbimin e mjeteve nga fondet vendore dhe të jashtme.

Rrjeti për Zhvillim Inkluziv aktivitetet e veta i zbaton në bazë të Programit trevjeçar të miratuar nga anëtarët.

Zbatimi i aktiviteteve financohet me mjete të komunave, përmes implementimit të projekteve, si dhe me mjete të organizatave ndërkombëtare.

<http://www.vardarregion.gov.mk/>

PLATFORMA PËR VEPRIM RURAL RAJONAL TË RAJONIT VERILINDOR PLANOR (PVRR)

Platforma për Veprim Rural Rajonal (PVRR) paraqet një formë të bashkëpunimit ndërkomunal – Trup i përbashkët i punës së komunave nga Rajoni Verilindor Planor (RVLP) për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zonave rurale dhe vendbanimeve të Rajonit. Në këtë bashkëpunim janë përfshirë të gjitha 6 komunat të Rajonit Verilindor Planor, më saktësisht: Kumanova, Kratova, Kriva Pallanka, Likova, Rankoci dhe Nagoriçani i Vjetër.

PVRR ka gjithsej 17 anëtarë ku përveç nga një përfaqësues nga zyrat për zhvillim ekonomik lokal, nga çdo komunë të RVLP, me përfaqësues të tyre marrin pjesë edhe sektori joqeveritar, dhomat ekonomike, GLV-të, Qendra për Zhvillimin e RVLP, biznes komuniteti, si dhe institucionet arsimore.

Qëllimi i përgjithshëm i Platformës për Veprim Rajonal Rural është që në kontinuitet të identifikojë, koordinojë dhe të ofrojë zgjidhje për çështjet ekonomike në zonat rurale të Rajonit Verilindor Planor, së këtejmi duke zhvilluar një sistem të qëndrueshëm të etablimit dhe ruajtjes së sinergjisë midis sektorit publik, joqeveritar dhe privat.

Qëllimet specifike të PVRR janë:

- të krijojë Platformë për Veprim Rural Rajonal (PVRR), e cila do të shërbejë si katalizatore për nevojat lokale dhe rajonale për planifikimin dhe zhvillimin e ekonomisë rurale.

- të sigurojë ndihmë për operatorët ekonomik në sektorin rural dhe fermerët të zhvillojnë hallka të qëndrueshme të vlerave dhe t'i përdorin resurset lokale në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim që të kenë përfitime më të mëdha nga produktet dhe shërbimet e tyre;

- të sigurojë një mjedis i cili do t'i ndjek dhe zbatojë parimet e proceseve të zhvillimit të qëndrueshëm lokal/rajonat ekonomik.

Platforma për Veprim Rural Rajonal (PVRR) aktivitetet e veta i zbaton në bazë të Programit trevjeçar, të miratuar nga anëtarët.

Zbatimi i aktiviteteve financohet me mjete të komunave, përmes implementimit të projekteve, si dhe me mjete të organizatave ndërkombëtare.

www.northeastregion.gov.mk

RRJETI I INTEGRUAR PËR ZHVILLIM RAJONAL NË RAJONIN PLANOR TË PELLAGONISË - RRIZHR

Rrjeti i Integruar për Zhvillim Rajonal në Rajonin Planor të Pellagonisë (RRIZHR) është një nismë e udhëhequr nga Qendra për Zhvillimin e Rajonit Planor të Pellagonisë, 9 komunat e Rajonit Planor të Pellagonisë, si dhe dhomat rajonale ekonomike dhe të zejtarëve, GLV-të, si dhe përfaqësues të universiteteve dhe sektorit civil.

Rrjeti në mënyrë formale u vendos në fillim të vitit 2015, me një mbështetje të siguar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Zyrës së Programit për Zhvillim pranë Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Shkup.

Rrjeti i Integruar është formuar në bazë të vendimeve për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, të miratuara nga ana e të gjitha nëntë (9) komunat e Rajonit.

Formimi i RRIZHR është në përputhje me qëllimet dhe aktivitetet e Programit pesëvjeçar për Zhvillimin e Rajonit Planor të Pellagonisë, si dhe konform Plan Veprimit trevjeçar për implementimin e Strategjisë Nacionale për Zhvillim të Balancuar Rajonal.

Qëllimin të cilin Rrjeti i Integruar dëshiron ta arrijë në kuadër të Rajonit është ta përmirësoj bashkëpunimin midis sektorit privat, publik dhe sektorit joqeveritar dhe ta përforcojë koordinimin midis këtyre sektorëve në implementimin e aktiviteteve të dedikuara për zhvillimin e rajonit. Përmes aktiviteteve të veta, Rrjeti i Integruar do të ndikojë mbi zhvillimin e ekonomisë së Rajonit dhe mbi përforcimin e vlerave të saj konkurrense.

Roli i Rrjetit është ta përmirësojë ambientin ekonomik, aspektet sociale dhe mjedisin jetësor.

Trupi i përhershëm i përbashkët ka 21 anëtarë nga sektori publik, nga biznes sektori, nga ai joqeveritar dhe arsimor.

Anëtarët e Trupit punues të komunave, i emërojnë kryetarët e këshillave komunal me vendim, në bazë të vendimeve të këshillave për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal. Anëtarët e tjerë i emërojnë organet më të larta të administrimit të institucioneve/organizatave prej të cilave vijnë. Mënyra e votimit dhe miratimit të vendimeve në RRIZHR është rregulluar me konceptin e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Trupit punues, përkatësisht nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të pranishëm të Trupit punues.

Rrjeti i Integruar për Zhvillim Rajonal të Rajonit Planor të Pellagonisë aktivitetet e veta i zbaton në bazë të Programit trevjeçar të miratuar nga anëtarët.

Zbatimi i aktiviteteve financohet me mjetet e komunave, përmes implementimit të projekteve, si dhe me mjetet e organizatave ndërkombëtare.

<http://pelagonijaregion.mk>

SEKSIONI I PËRBASHKËT PËR EFIKASITET ENERGJETIK TË RAJONIT PLANOR TË VARDARIT

Me mbështetjen e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe UNDP, përmes nënshkrimit të Marrëveshje për Bashkëpunim, 8 komuna formuan seksion të përbashkët për efikasitet energjetik të Rajonit Planor të Vardarit dhe Info-Qendër Rajonale për Efikasitet Energjetik!

Me funksionimin e seksionit të përbashkët, sot ky Rajon është disa shkallë më përpara dhe është jo vetëm më konkurrent por edhe shndërrohet në një partner të mirëfilltë për investime më të mëdha në objekte dhe infrastrukturë me karakter publik.

Seksioni i përbashkët është orientuar edhe në drejtim të avancimit të efikasitetit energjetik në fushën e banimit dhe ndërtimit, si dhe në funksionimin e objekteve afariste në sektorin privat.

Në këtë seksion punojnë dy nëpunës shtetërorë, ndërsa në kryerjen e detyrave të punës u ndihmon edhe nga një person për kontakt nga administratat komunale të tetë komunave.

Të punësuarit në seksionin e përbashkët ofrojnë mbështetje në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve për efikasitet energjetik të shkollave dhe për të gjitha objektet publike lokale: kopshtet e fëmijëve dhe objektet për kulturë dhe sport.

Formimi i një trupi të këtyllë ka për qëllim t'i bashkojë interesat e të gjitha komunave të Rajonit, përmes përfshirjes të të gjitha palëve të interesuara. Gjatë planifikimit dhe përcaktimit të prioritetëve përfshihet edhe biznes-komuniteti, sektori civil dhe drejtorët e institucioneve publike.

Është krijuar Regjistër i 107 objekteve publike, me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 120 000 metra katrorë, në të cilat duhet të sigurohet efikasitet energjetik, me ç'rast në masë të konsiderueshme do të reduktohen shpenzimet e punës.

U zbatua një fushatë gjithëpërfshirëse dedikuar të gjithë qytetarëve, me theks të veçantë mbi shkollat.

Ideja është që mesazhet e politikave evropiane për efikasitet energjetik të arrijnë deri te çdo qytetar në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

Vetëm për dy vjet efektet janë të dukshme përmes zëvendësimit të plotë të ndriçimit rrugor me poçe kursyese, si dhe zëvendësimit të fasadave me fasada efikase energjetike në një numër të madh shkollash.

Bëhet fjalë për një Projekt të suksesshëm rajonal i cili plotësisht është në korrelacion me politikën nacionale për kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale duke i perceptuar efektet pozitive, në mënyrë që këtë praktikë të mirë ta mbështes edhe në shtatë rajonet e tjera planore, me ç'rast do të përfshiheshin të gjitha tetëdhjetë (80) komunat. Në të gjitha komunat realizohen masa për kursimin e energjisë dhe për shërbime më cilësore dhe më ekonomike për qytetarët, megjithatë analizat tregojnë se efektet dyfishohen kur punohet në rrjet dhe në mënyrë të koordinuar me përfshirjen e të gjitha palëve të interesit në një rajon planor.

